



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania
Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri



Njoftim për Mediat

Datë:

27 Shkurt 2013

Për:

Përfaqësuesit e Medias në Shqipëri

Projekti i Ri Tre Vjeçar për Forcimin e Qeverisë Vendore Nisi Sot nga Këshilli i Europës, Bashkëpunimi Zviceran dhe Ministria e Brendshme

Një partneritet i përbashkët ndërmjet Bashkëpunimit Zviceran, Këshillit të Evropës dhe Ministrisë së Brendshme, ka bërë të mundur një projekt të ri për forcimin e qeverisë vendore në Shqipëri. Projekti do të synojë futjen e metodave të reja në mënyrë që të përmirësojnë ecurinë e njësive të qeverisjes vendore.

E mërkurë, shkurt 27, Tirana - Forcimi i mëtejshëm i strukturave të qeverisjes vendore është vendimtar për demokratizimin e Shqipërisë dhe procesin e decentralizimit. Ky mesazh u dha me zë të lartë dhe të qartë sot gjatë nisjes së një projekti të ri të titulluar "Forcimi i Strukturave të Qeverisjes Vendore dhe Bashkëpunimi i Përfaqësuesve të Zgjedhur Vendorë në Shqipëri". Nisja u zhvillua në Hotel Tirana International dhe u ndoq nga Ambasadori i Zvicrës, Sh.T. Alexander Wittwer, Zëvendësministri i Brendshëm, Ferdinand Poni, përfaqësues nga Këshilli i Evropës dhe Bashkëpunimi Zviceran, si dhe përfaqësues nga qeveria vendore dhe donatorët.

"Ngjarja e sotme shënon një tjetër arritje në përpjekjet tona zhvillimore ndërsa nisim një fazë të re të projektit tonë të përbashkët për forcimin e qeverisjes vendore", tha Sh.T. Alexander Wittwer, ambasadori zviceran në Shqipëri. Ambasadori Wittwer theksoi rolin e luajtur nga Këshilli i Evropës dhe Ministria e Punëve të Brendshme në mbështetjen e strukturave të pushtetit vendor dhe rëndësinë që ka qeveria vendore për zhvillimin demokratik të vendit. "Unë jam i bindur se më shumë bashkëpunim ndër-bashkiak dhe një menaxhim më i mirë i burimeve njerëzore do të provohen si metoda të suksesshme për të patur struktura të qeverisjes vendore plotësisht funksionale dhe performuese, si dhe cilësi më të mirë të shërbimeve për qytetarët", tha ambasadori.

Gjatë fjalës së tij, Alfonso Zardi, Shef i Departamentit të Qeverisjes dhe Institucioneve Demokratike të Këshillit të Evropës, mirëpriti besimin dhe kontributin e Qeverisë zvicerane ndaj Këshillit të Europës, si dhe angazhimin e Ministrisë së Brendshme për reformën e vetë-qeverisjes vendore. Ai theksoi se kjo fazë e re e projektit hap shtigje të reja për të thelluar bashkëpunimin me autoritetet shqiptare, me qëllim për të përmirësuar më tej funksionimin e vetë-qeverisjes vendore në Shqipëri. Z. Zardi theksoi se së bashku Këshilli i Evropës dhe autoritetet shqiptare mund të kontribuojnë më tej për të gjetur zgjidhje efikase dhe të realizueshme për një bashkëpunim ndër-bashkiak të qëndrueshëm dhe një sistem të avancuar për menaxhimin e burimeve njerëzore në Shqipëri.

Helen Eadie, duke folur në emër të e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale, Këshilli i Evropës, kujtoi se projekti është pjesë e prioritetëve të bashkëpunimit midis Këshillit të Evropës dhe Shqipërisë. Ajo paraqiti nismën e Kongresit që synon të ushqejë procesin për një platformë të përbashkët të dialogut për autoritetet vendore dhe rajonale. "Ne do të ndihmojmë autoritetet vendore dhe rajonale në Shqipëri për të rritur bashkëpunimin dhe

dialogun nga një pikëpamje shumë-partizane dhe një qasje pluraliste”, theksoi ajo. Zj. Eadie gjithashtu i vuri theksin pranisë së shumë kryebashkiakëve, krerëve të komunave, dhe kryetarëve të Qarqeve të cilët “kanë treguar tashmë një përkushtim të fortë ndaj synimeve të projektit dhe ndaj punës për çështje me shqetësim të përbashkët”. “Me këtë projekt, në shpresojmë të kontribuojmë më tej për zhvillimin e qeverisjes politike vendore si një pjesë të dukshme të demokracisë dhe për të ndërtuar besim dhe konfidencë tek qytetarët në institucionet demokratike të Shqipërisë”, shtoi ajo.

Zëvendësministri i Brendshëm, Ferdinand Poni siguroi partnerët ndërkombëtarë mbi angazhimin e qeverisë ndaj procesit të decentralizimit dhe autonomisë së qeverisjes vendore. “Për ne, përmirësimi i funksionimit të qeverisjes vendore është një detyrim dhe një objektiv në të njëjtën kohë”, tha Zëvendësministri Poni. Ai u bëri thirrje përfaqësuesve të pushtetit vendor për të vazhduar marrjen e përgjegjësive dhe për të rritur funksionet dhe performancën e tyre si parashikohet në qëllimet e projektit.

Marco Leidekker, Shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, moderoi aktivitetin. Pas fjalimeve, pjesëmarrësit morën pjesë në një pritje dhe patën mundësi të krijojnë rrjete dhe shoqërim me partnerët, aktorët dhe përfituesit.

Me financim nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri, projekti do të zbatohet nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Brendshme dhe aktorë të tjerë. Ajo pason një fazë të mëparshme ku u provuan metoda të reja për përmirësimin e funksionimit të qeverisjes vendore si *bashkëpunimi ndër-bashkiak* dhe *menaxhimi i burimeve njerëzore*.

Projekti i ri do të trajtojë disa kufizime dhe dobësi të pranishme në nivel të qeverisjes vendore në Shqipëri, të tilla si bashkëpunim i kufizuar mes bashkive, zbatimi i ulët i menaxhimit të burimeve njerëzore, dhe mungesa e përfaqësimit të unifikuar të strukturave të qeverisjes vendore. Gjatë fazës së parë që u zhvillua deri në fund të vitit 2012, rezultatet kryesorë përfshinë një njohje në rritje të bashkëpunimit ndër-bashkiak si një mjet për efikasitet më të mirë të shërbimeve, prezantimin e praktikave moderne të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe një vlerësim të qeverisjes vendore sipas Kartës Evropiane që shërbeu si bazë për fazën aktuale të projektit.

Për Bashkëpunimin Zviceran, ky projekt është një prej përpjekjeve të shumta për të forcuar demokracinë dhe decentralizimin e mëtejshëm në Shqipëri. Si për Bashkëpunimin Zviceran dhe Këshillin e Evropës, mbështetja e strukturave të pushtetit vendor është një pjesë thelbësore e strategjive të tyre përkatëse zhvillimore për Shqipërinë.

Për informacione të mëtejshme ju lutem kontaktoni:

Elda Bagaviki, Zyrtare Kombëtare Programi, Bashkëpunimi Zviceran
elda.bagaviki @ sdc.net

Ardian Dhima, Menaxher Projekti, Këshilli i Evropës
Ardian.DHIMA @ coe.int